

VENDIM
Nr.17, datë 13.2.2008

PËR MOSFILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT PËR KËRKESËN E SHOQËRISË
“EN- KU” SHPK

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.44, datë 24.7.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.21, datë 4.4.2007 “Rregullorja e procedurave të licencimit”, neni 8, pikat 1, 4, dhe 5, si dhe neni 15, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 13.2.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “En-Ku” sh.p.k., për modifikimin e licencës nga shoqëria “Dardania Energji” sh.p.k. te shoqëria “En-Ku” sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Mosfillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës, për modifikimin e licencës me nr.10, seria PV03P, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.20, datë 19.12.2003 për shoqërinë “Dardania Energji” sh.p.k.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, si dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për përgatitjen e njoftimit për vendimin e dhënë nga ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE-s
Bujar Nepravishta